



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. 03-02/153/A Prot. No.
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum 25.01.2017 Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.01.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4648/16, për znj. Diana Bajrami - Reka, Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Kaçanikut, për shkak se zyrtarja e lartë publike e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r g y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, znj. Diana Bajrami - Reka, Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Kaçanikut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat D.P.H "Tandemi", është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtarja e lartë, është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi njoftuar zyrtaren e lartë për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të heq dorë nga ushtrimi i funksionit person i autorizuar në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, znj. Bajrami - Reka, ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/33/17), me të cilën dëshmohet se zyrtarja e lartë është larguar nga ushtrimi i funksionit person i autorizuar në biznes privat.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

